

Data di pubblicazione: 23 dicembre 2022

GIOVANNI LUCHENA

Parathënie¹

Hyrje: Monografia e titulluar “Inovacioni dhe tradita në të drejtën e ndihmës Shtetërore në kuadrin e ri ligjor”, e paraqitur për vlerësimin tim trajton një temë shumë aktuale sepse ka të bëjë me profilet e ndikimit ligjor dhe ekonomik që përfshijnë organe dhe institucione të brendshme dhe “evropiane” të pandara nga roli i Shtetit në ekonomi.

Autorja Anduena Gjevori, e ka zhvilluar këtë temë gjatë eksperiencës kërkimore pranë Departamentit të Ekonomisë dhe Financës, në Universitetin e Barit “Aldo Moro”, e angazhuar si kërkuese vizitore, nën mbikqyrjen time.

E kam ndjekur hartimin e këtij punimi duke diskutuar me autoren dinamikat që po shfaqeshin gradualisht, veçanërisht në dritën e drejtimit orientues të përkohshëm të miratuar pas shpërthimit të pandemisë.

¹ Botojmë Hyrje në librin e Anduena Gjevorit, *Inovacioni dhe tradita në të drejtën e ndihmës Shtetërore në kuadrin e ri ligjor*

Paraprakisht, duhet theksuar se monografia është rezultat i një analize të thelluar të subjektit në mënyrë graduale, duke kryer studime të rëndësishme në lidhje me ndihmën Shtetërore të publikuara në revista ndërkombëtare, duke përfshirë revista shkencore të Klasit A (sipas klasifikimit cilësor të revistave shkencore nga Agjencia Italiane për Cilësinë e Kërkimit Shkencor).

Për sa më sipër, zhvillimi i argumenteve është rezultat i një pune të saktë, të menduar dhe të pjekur në nivelin e metodologjisë së kërkimit shkencor. Reflektimet në monografi mund të konsiderohen si zhvillim i natyrshëm i mendimeve të nisura në atë kohë: pra ato janë përpunimi i menduar i një rruge kërkimi të thelluar të një teme që është në zhvillim të vazhdueshëm.

Përditësimi shkencor dhe kulturor kërkon një kontribut të vazhdueshëm studimor dhe kërkimor pikërisht për shkak të karakteristikave të veçanta të sipërpërmendura.

Kjo shpjegon titullin e vëllimit i cili analizon kuadrin ligjor të ndihmës Shtetërore në një perspektivë diakronike.

Përmbatja. *Terminus a quo* është disiplina e konsoliduar e ndihmës Shtetërore, së cilës i janë bashkëngjitur ndryshime dhe shtesa të vazhdueshme në lidhje me raste të cilat shfaqen kohe pas kohe në kuadër të veprimtarisë së Komisionit Evropian dhe që pasojnë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të Bashkimit Evropian, të cilat, shpesh, janë në përputhje të përsosur me konkluzionet që lidhen me pajtueshmërinë e ndihmës Shtetërore.

Parathënie

Struktura e monografisë përmban aspekte dhe probleme të disiplinës së ndihmës Shtetërore në një këndvështrim organik. Trajtohen temat kryesore që lidhen me formulimet më të fundit ligjore dhe të jurisprudencës mbi ndihmën Shtetërore për ndërmarrjet. Doktrina e cituar në tekst është e gjerë dhe pasqyron rrymat më të rëndësishme të mendimit mbi këtë temë.

Pas hyrjes, e cila ilustron arsyet që nxitën kërkimin, autorja fokusohet në konceptin ligjor të ndihmës Shtetërore. Ky është një vlerësim me rëndësi themelore për qëllimin e studimit të ndihmës Shtetërore. Koncepti ligjor, në fakt, ka pësuar një evolucion të karakterizuar nga cikle ekonomike, nga krizat e ndodhura që prej krizës së naftës (vitet e shtatëdhjetë të shekullit të kaluar) deri në ato të fillimit të shekullit të njëzetë-e-një, nga nevojat e shprehura nga shtetet në lidhje me rikuperimin e një pjese të sovranitetit të tyre ekonomik, nga kontributi i jurisprudencës së gjykatave të Bashkimit Evropian, e kështu me radhë. Rindërtimi i nocionit nëpërmjet analizës së saktë të kriterëve përbërëse të ndihmës i lejon autores të thellohet në dinamikat më të fundit të implementimit: nga njoftimi i vitit 2016 mbi nocionin e ndihmës Shtetërore deri tek drejtimi orientues i përkohshëm që rezulton nga emergjenca Covid-19, argumentimi lejon verifikimin e mënyrave nëpërmjet të cilave Komisioni Evropian vepron kur i kërkohet të vendosë për pajtueshmërinë e ndihmës në përputhje me nenin 107 (1) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Çdo kriter i veçantë analizohet sipas një rruge logjike rindërtuese funksionale jo vetëm për të kuptuar nocionin e sipërpërmendur nga pikëpamja e përgjithshme, por

edhe për të testuar evolucionin e qasjes së Komisionit ndaj situatave të jashtëzakonshme dhe të përkohshme.

Në këtë pikë, fillon analiza e kompetencave të institucioneve të Bashkimit Evropian në disiplinën në fjalë. Siç dihet, në këtë fushë të së drejtës së konkurrencës, Komisioni Evropian gëzon një diskrecion të gjerë për shkak të kompetencës ekskluzive që i është dhënë nga Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian në fushën e ndihmës Shtetërore. Më tej, shqyrtohen llojet e ndryshme të ndihmës si nga pikëpamja e përmbajtjes ashtu edhe nga ajo procedurale.

Siç u përmend më lart, roli i Gjykatave të Bashkimit Evropian është i një rëndësie të madhe: autorja shqyrton të gjitha aspektet procedurale të nevojshme për t'iu drejtuar gjykatave të sipërpërmendura dhe trajton, gjithashtu, llojet e padive që mund të ngrihen.

Një aspekt interesant dhe njëkohësisht inovativ lidhet me rolin e gjykatave kombëtare të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat tradicionalisht nuk zënë një vend të rëndësishëm pikërisht për shkak të kompetencës ekskluzive të Komisionit Evropian në këtë fushë. Megjithatë, në një perspektivë kohore, roli i gjykatave kombëtare po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, siç dëshmohet nga komunikimi i fundit i Komisionit të cilin autorja thekson dhe zhvillon siç duhet.

“Kapitulli” i reformave është shumë interesant sepse vë në pah risitë më të fundit në fushën e ndihmës Shtetërore, gjithmonë në vazhden e traditës. Ky është një proces që nuk është ezauruar, në kuptimin që modernizimi është rezultat i një konfrontimi të vazhdueshëm midis institucioneve dhe Shteteve Anëtare (duke marrë

Parathënie

parasysh gjithashtu rolin “administrativ” të Komisionit) në lidhje me përshtatjen me situatat që janë krijuar dhe me nevojat e shteteve të cilët nuk mund t'ia lënë Komisionit të gjitha mjetet e ndërhyrjes në ekonomi.

Në këtë kontekst, një risi absolute është shqyrtimi i disiplinës për ndihmën Shtetërore në zonën e Ballkanit. Në punime të tjera, autorja shqyrton plotësisht ndihmën Shtetërore në Kosovë dhe Serbi. Ky është një kontribut novator dhe jashtëzakonisht interesant sidomos në perspektivën e anëtarësimit të disa vendeve në Bashkimin Evropian, si në rastin e Shqipërisë. Studimi i kryer nga autorja mund të përbëjë një model bazë për legjislacionin që duhet të miratohet në vend, sepse ai përcakton pasojat e legjislacionit evropian në nivel kombëtar. Në thelb, studimi i lejon ligjvënësit të brendshëm të përdorë një mjet shkencor-praktik për të përmbushur sa më mirë detyrat që do t'i kërkohen të përmbushë ndoshta në një të ardhme të afërt.

Në përfundim, bazuar në eksperiencën time kërkimore, pohoj pa hezitim se monografia paraqet argumente të bazuara në një metodë ligjore rigoroze, trajton çështjet më të fundit në mënyrë shteruese dhe paraqet një pikënisje të vlefshme për shkencën juridike.

Publikimi paraqet arritje të reja në lidhje me burimet normative, doktrimore dhe jurisprudenciale; zhvillon argumente kritike në lidhje me kontekstin teorik para-ekzistues; trajton në mënyrë të përshtatshme ligjin dhe literaturën për këtë temë.

Vlerësimi përfundimtar është i shkëlqyer pasi arrin nivelet e duhura të origjinalitetit, njohurive dhe aftësisë për të përdorur burime të literaturës më të kualifikuar.